

DERI TE :

KËSHILLI MËSIMOR-SHKENCOR I FAKULTETIT FILOZOFIK

Në bazë të vendimit Nr. 16-493/2 të datës 10.07.2025. të Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit Filozofik, për formimin e Komisionit për vlerësimin e punimit të paraqitur për punimin e disertacionit të doktoraturës, si dhe në bazë të nenit 51 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit dhe studimit në ciklin e tretë të studimeve-studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës, komisioni në përbërje: 1.Prof.Dr.Kushtrim Ahmeti, 2.Prof. Dr.Ibish Kadriu, anëtar, 3.Prof.Dr. Qani Nesimi, anëtar, 4. Prof.dr. Ardita Abduli-Reka dhe 5.Prof.dr.Abdynaser Sinani, mentor, pasi vlerësoi punimin e disertacionit të doktoraturës të doktoraturës të kandidatës Mr.sc.Hana Shala, paraqet këtë:

RAPORT

për vlerësimin e disertacionit së doktoraturës

Të dhënat biografike të kandidatës

Mr.sc.Hana Shala ka lindur më 08.04.1987 në Prishtinë, Republika e Kosovës, ku edhe jeton. Arsimimi: Universiteti i Tetovës - Maqedonia e Veriut, doktoraturë drejtimi Sociologji e Kulturës, më 2016 në Universitetin e Tiranës-Shqipëri ka kryer master Shkencor – Sociologjia e Zhvillimeve Shoqërore, kurse më 2008 në Universitetin e Prishtinës ka marrë gradën shkencore bachelor.- sociologji.

Përvoja Profesionale • 2010 Punëtorë Sociale / Sociologe, SOS Children's Villages – Prishtinë
• 2024 – Eksperte hulumtimi mbi shërbime sociale dhe urbanistike, O.U.D. ARCHITECTS – Art Tech “Tulltorja”, Prishtinë • 2022–2023 – Eksperte hulumtimi – sociologji urbane, Superwien – Vjenë • 2021 – Asistente hulumtimi për të drejtat e punëtorëve, IQ Consulting • 2019–2020 – Eksperte sociale në projekt të UNICEF, ASD Group – Prishtinë • 2014–2015 – Eksperte hulumtimi për tema sociale, Balkan Institute for Policy – IPOL • 2013–2016 – Hulumtuese, IQ Consulting – Prishtinë

Publikime Shkencore 1. MIGRATION, REASONS AND MOTIVES IN KOSOVO SOCIETY
https://drive.google.com/file/d/1TILMajIq_iePcobwJ9Fp-8L5PuUIF1O8/view 2.
 DYNAMICS AND CAUSES OF BIRTH-RATE DECLINE IN POST-WAR KOSOVO
<http://centrum.mk/wp-content/uploads/2021/07/PJESA-15.pdf> 3. Kosovar Attitudes towards
 Homosexuality and Lesbianism and the Legalisation of Same-Sex Civil Unions
https://www.pjlss.edu.pk/pdf_files/2024_2/15493-15509.pdf - SCOPUS 4. Convicted Women
 in the Republic of Kosovo 2003-2019: The Volume, Dynamics, and Structure of Criminal Acts
 in Comparative Aspect. [https://www.pjcriminology.com/wp-content/uploads/2024/04/53-](https://www.pjcriminology.com/wp-content/uploads/2024/04/53-Convicted-Women-in-the-Republic.pdf)
 Convicted Women-in-the-Republic.pdf SCOPUS Konferenca Shkencore • 2019 – Migration,
 reasons, motives and consequences in the society – 6th International Conference of the Faculty
 of Philosophy – Tetovë, Maqedonia • 2021 – Decline in the birth rate in Kosovo: Dynamics
 and Causes – Comparative Studies in Modern Society: The Balkans – Prizren, Kosovë
 Certifikime dhe Anëtarësime • Licencë për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare -
 Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare – MPMS – Republika e Kosovës
 Gjuhët • Shqip: Gjuha amtare • Anglisht: B2 Referenca • Mr. Roland Krebs – Superwien Email:
krebs@superwien.com • Mrs. Arlinda Beka – Universiteti i Prishtinës Email: [arlinda.beka@uni-](mailto:arlinda.beka@uni-pr.edu)
[pr.edu](mailto:arlinda.beka@uni-pr.edu)

Gjatë periudhës së studimeve të ciklit të tretë të doktoraturës kandidatja Mr.sc. Hana Shala
 ka kryer me sukses provimet dhe prezentimet konferencat doktorale si edhe obligimet tjera
 të parapara me Rregulloren për studimet e doktoraturës të Universitetit të Tetovës.

1. Analizë e punimit të doktoraturës me titull: “Sfidat e familjes kosovare në tranzicion:
 emigracioni dhe nataliteti”.

Në këtë tezë doktore ne titull: “Sfidat e familjes kosovare në tranzicion: emigracioni dhe
 nataliteti”, është trajtuar tema sfidat e familjes kosovare në periudhën e tranzicionit, duke u
 përqëndruar në dy dukuri madhore që e kanë përshkruar shoqërinë kosovare ndër dekada:
 emigracionin dhe natalitetin. Duke shfrytëzuar qasjen e përzier metodologjike atë sasiore
 (kuantitative) dhe qasjen cilësore (kualitative), gjatë përgaditjes së kësaj teze të doktoraturës
 doktorantja Hana Sahala ka shfrytëzuar edhe të dhëna statistikore dhe materiale arkivore.
 Në nivel teorik, punimi ndërthur qasjet strukturore, teoritë neoklasike, teoritë e rrjeteve
 (network) dhe ato të tregut të punës për migracionin, ndërsa për natalitetin shfrytëzohet teoria
 e tranzicionit demografik, funksionalizmin strukturor, teoria e konfliktit dhe e ndërveprimit
 simbolik. Gjetjet nxjerrin në pah ndërveprimin e faktorëve ekonomikë, politikë dhe kulturorë

në motivimin e familjeve kosovare për të emigruar, ndërkohë që zhvendosja e vlerave tradicionale dhe paqëndrueshmëria institucionale kanë ndikuar ndjeshëm në rënien e normave të lindshmërisë. Punimi konkludon se pa ndërhyrje strategjike e të koordinuara, tendencat aktuale demografike do të vazhdojnë të cenojnë kohezionin social dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës.

Trajtimi i problemit të familjes kosovare, me impakt të gjerë shoqëror, sidomos në këtë periudhë tranzicioni, kohë kjo e cila është karakterizuar si mjaftë e rëndësishme dhe me interes të përgjithshëm për Kosovën, ashtu edhe për trendin e natalitetit dhe emigracionit në të gjitha trevat shqiptare, andaj kjo temë parqet problem kërkimi aktual dhe i qëlluar si një hulumtim, jo vetëm nga interesi shoqëror, por edhe për faktin e mungesës të hulumtime të kësaj natyre në Republikën e Kosovës.

Qëllimi dhe arsyet e hulumtimit

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të analizojë dhe të interpretojë sfidat me të cilat përballet familja kosovare në periudhën e tranzicionit, me fokus të veçantë mbi dy fenomene kyçe: emigracionin dhe natalitetin.

Studimi synon të:

- Sqarojë faktorët strukturorë, ekonomikë, politikë dhe kulturorë që nxisin emigracionin e popullsisë, veçanërisht të rinjve dhe familjeve të reja;
- Analizojë shkaqet e rënies së natalitetit dhe të hulumtojë lidhjet ndërmjet kushteve sociale, ekonomike dhe normave kulturore në raport me lindshmërisë në Kosovë;
- Paraqesë një pasqyrë historike dhe bashkëkohore të emigracionit dhe natalitetit, duke shfrytëzuar të dhëna statistikore, dokumente arkivore dhe analiza teorike;
- Ofrojë propozime konkrete për politika dhe masa që mund të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të jetës familjare dhe në ndalimin e tendencave negative demografike.

Metodologjia e hulumtimit

Studimi është mbështetur në një qasje të kombinuar metodologjike që ndërthur teknika kuantitative dhe kualitative për të siguruar një analizë të gjithanshme dhe të balancuar të fenomenit të emigracionit dhe natalitetit në Kosovë. Duke i shfrytëzuar teknikat, instrumentet matëse dhe metodat e përdorura gjatë realizimit të studimit, paraqiten rezultatet e kërkimit sasiore, të mbështetura në të dhëna statistikore nga anketimia, si dhe të dhënat nga qasja cilësore, përmes intervistave të thelluara me studiues relevantë. Përcaktohet gjithashtu mënyra e përzgjedhjes së respondentëve dhe procesi i analizës së të dhënave. Anketa ka përfshirë 436 të rinj të moshës 18–35 vjeç, të shpërndarë në zona të ndryshme të vendit. Pyetësi ka përmbytur 39 pyetje që trajtojnë tema të tilla si: gjendja familjare, arsyet për emigrim, dëshira për të pasur fëmijë, perceptimi për të ardhmen dhe siguria sociale. Ky instrument ka siguruar të dhëna statistikore që ofrojnë një pasqyrë të gjendjes reale. Intervista të thelluara gjysmë-strukturuara. Këto intervista janë zhvilluar me ekspertë të politikave sociale, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile. Qëllimi ka qenë të merret një perceptim më i thellëuar dhe interpretim i kontekstit shoqëror, ekonomik dhe kulturor që ndikon në vendimmarrjen e individëve për migracion dhe lindje të fëmijëve. Të dhënat empirike, do të nxiren nga mostra e qëllimshme nëpërmjet pyetësorit anketues e cila është formuar nga 210 respondent të cilët jetojnë në Republikën e Kosovës. Anketimi realizohet nëpërmjet dy formave: anketimit tradicional përmes shpërndarjes së pyetësorëve dhe grupe qëllimore për këtë hulumtim dhe anketimi online përmes aplikacionit në “google”. Si metoda ndihëse të kërkimit do të shfrytëzohen intervista jo e strukturuar si metodë cilësore, dhe analiza e përmbyajtjes. Do të intervistohen ekspertë nga fusha e migracionit dhe natalitetit, me qëllim të shqyrtohen përvoja historike dhe aktuale e këtyre sfidave të qytetarëve kosovarë në këtë periudhë sfiduese. Do të realizohen intervista me ekspert të fushës, do të hulumtohen shkaqet dhe pasojat e emigrimit, cila mund të ishte ndërlidhja me rënien e natalitetit, por edhe të nxirren përfundimet dhe sygjërimet e mbështetura nga rezultatet e këtij studimi. Me metodën e analizës së përmbyajtjes, nëpërmjet së cilës do të analizohen dokumentacioni i shkruar mbi qasjet e migrimit me pasojat dhe perspektivat bashkëkohore të saj.

Përdorimi i burimeve sekondare: është bërë analizë e të dhënave statistikore nga Agjencia e Statistikave e Kosovës, dokumenteve ligjore dhe strategji, si dhe literaturës shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare mbi tranzicionin demografik, teoritë e migracionit dhe natalitetit.

Teknika CAPI me KoboToolbox: Të dhënat janë mbledhur në terren në mënyrë dixhitale duke përdorur KoboToolbox, që ka garantuar saktësi më të madhe, menaxhim më efikas të të dhënave dhe eliminim të gabimeve gjatë procesit të regjistrimit të përgjigjeve.

Hipoteza e përgjithshme:

- Supozimi është se shkaqet themelore mbi emigracionin e lartë në Kosovë janë: papunësia, standardi i ulët, mungesa e perspektivës, dhe mungesë të kapacitetit për udhëheqje politike. Të gjitha këto rrethana janë sfidë për familjen kosovare, e cila gjithnjë e më tepër po e humbë funksionin e saj social.

Hipotezat e veçanta:

- H1: Papunësia dhe standarti i ulët janë shkaktarët kryesorë të emigrimit?
- H2: Mungesa e perspektivës tek të rinjtë si shkaktar tjetër i emigrimit?
- H3: Mungesa e zhvillimit ekonomik ka ndikuar në ujen e natalitetit?
- H4: Planifikimi familjar ka ndikuar në uljen e natalitetit?
- H5: Cilësia e ulët e arsimimit dhe jo perspektiva në Kosovë kanë krijuar hapësirë për emigrim?
- H6: Shkalla e lartë e korrupsionit dhe krimit të organizuar ka ndikuar në rritjen e shkallës së emigrimit?

Arsyet që kanë nxitur realizimin e këtij hulumtimi lidhen me rëndësinë jetike të emigracionit dhe natalitetit në formësimin e strukturës demografike dhe shoqërore të Kosovës. Disa nga arsyet kryesore janë:

- *Ndikimi i thellë i emigracionit* në zbrazjen e vendit nga popullsia aktive, në ndryshimin e strukturës së tregut të punës dhe në sfidat për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social;
- *Rënia e natalitetit*, e cila përbën një ndër sfidat më serioze për ripërtëritjen natyrore të popullsisë dhe për kohezionin social në të ardhmen;
- *Mungesa e studimeve të integruara* që të trajtojnë në mënyrë të ndërthurur dhe të thelluar lidhjen ndërmjet emigracionit dhe natalitetit në kontekstin e tranzicionit shoqëror në Kosovë;

- *Nevoja për të krijuar bazë shkencore për hartimin e politikave që synojnë stabilizimin demografik dhe përmirësimin e mirëqenies së familjes kosovare.*

- **Kontributi shkencor i hulumtimit**

Rëndësia e këtij hulumtimi me titull : “Sfidat e familjes kosovare në tranzicion: emigracioni dhe nataliteti”, është e shumëfishtë dhe thelbësore për zhvillimin socio-demografik të Kosovës. Studimi trajton dy dukuri kyçe që kanë ndikim të thellë në strukturën e popullsisë dhe të shoqërisë: emigracionin dhe natalitetin.

Aspektet kryesore që e përcaktojnë rëndësinë e tij janë: a) ndikimi në strukturën demografike dhe sociale sepse hulumtimi vlerëson emigracionin si një faktor që ka shkaktuar zbrazjen e vendit nga popullsia aktive, ka ndryshuar strukturën e tregut të punës dhe ka krijuar sfida për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social. Po ashtu, rënia e natalitetit paraqitet si kërcënim për ripërtëritjen natyrore të popullsisë dhe për kohezionin social në të ardhmen, b) mungesa e studimeve të integruara, pra plotësimi i boshllëkut shkencor, pasi mungojnë studime të ndërthurura që analizojnë lidhjet midis emigracionit dhe natalitetit në kontekstin e tranzicionit shoqëror në Kosovë. Kjo e bën hulumtimin një kontribut të rëndësishëm akademik dhe praktik. c) mbështetja për hartimin e politikave publike ngase ky hulumtim krijon një bazë shkencore për hartimin e politikave dhe masave që synojnë stabilizimin demografik dhe përmirësimin e mirëqenies së familjes kosovare. Gjetjet mund të jenë udhërrëfyes për institucionet dhe politikëbërësitë për të ndërmarrë hapa të nevojshëm në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përballimit të sfidave demografike, dhe d) kontributi për zhvillimin e teorive dhe praktikave sociale si trajtim i ndërthur teorik dhe analiza të thelluara sociologjike për të ofruar një kuptim më të plotë të dinamikave shoqërore që lidhen me familjen, lindjet dhe migrimin.

Pritjet shkencore të hulumtimit

Ky disertacion i doktoraturës sipas strukturës ndahet në dy pjesë: në pjesën teorike dhe pjesa empirike. Pjesa teorike ka për qëllim kryesor të analizojë dhe të interpretojë sfidat me të cilat përballet familja kosovare në periudhën e tranzicionit duke vazhduar me studime specifike në aspektin e zhvillimeve të etapave të ndryshme kohore, sidomos të politikave mbi familjen në korrelacion me migracionin.

Natyrisht se tërë kjo pritet të rezultojë me një unifikim të dhënave që janë paraqitur në forma të ndryshme, por më së paku shkencore, deri më tani, por edhe të atyre që s’janë paraqitur ende.

Gjetjet kanë rezultuar si një studim sociologjik për një periudhë tejet të rëndësishme, për shoqërinë kosovare. Studimi synon të sqarojë faktorët strukturorë, ekonomikë, politikë dhe kulturorë që nxisin emigracionin e popullsisë, veçanërisht të rinjve dhe familjeve të reja; analizojë shkaqet e rënies së natalitetit dhe të eksplorojë lidhjet ndërmjet kushteve sociale, ekonomike dhe normave kulturore me normat e lindshmërisë në Kosovë; të paraqesë një pasqyrë historike dhe bashkëkohore të emigracionit dhe natalitetit, duke shfrytëzuar të dhëna statistikore, dokumente arkivore dhe analiza teorike; të ofrojë propozime konkrete për politika dhe masa që mund të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të jetës familjare dhe në ndalimin e tendencave negative demografike.

Përtej ekzaminimit të rrethanave e situatave historike pritet që studimi të ofrojë një qasje të re sociologjike që provon të nxjerr ndryshimet e shpejta të familjes shqiptare, si pasojë e faktorëve global dhe synimit për të sfiduar aspiratat e postmodernitetit.

Si rezultat i zgjerimit të mëtejshëm ky punim pretendon edhe një dimension multidiciplinar të studimit shkencor të familjes, i cili do t'i ndihmojë, jo vetëm sociologëve por edhe autorëve tjerë, studiuesve dhe atyre që janë të apasionuar pas çështjeve të familjes.

Ky studim ka arritur këto objektiva:

- Ndikimi i thellë i emigracionit në zbrazjen e vendit nga popullsia aktive, në ndryshimin e strukturës së tregut të punës dhe në sfidat për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social;
- Rënia e natalitetit, e cila përbën një ndër sfidat më serioze për ripërtëritjen natyrore të popullsisë dhe për kohezionin social në të ardhmen;
- Mungesa e studimeve të integruara që të trajtojnë në mënyrë të ndërthurur dhe të thelluar lidhjen ndërmjet emigracionit dhe natalitetit në kontekstin e tranzicionit shoqëror në Kosovë;
- Nevoja për të krijuar bazë shkencore për hartimin e politikave që synojnë stabilizimin demografik dhe përmirësimin e mirëqenies së familjes kosovare.

3. Fusha shkencore e hulumtimit

Disertacioni i doktoraturës i kandidatës Hana Shala është realizuar në fushën e sociologjisë së familjes respektivisht paraqet një studim shumëdisciplinor i ndërlidhur me migracionin, natalitetin dhe aspektet socio-ekonomike dhe politike të shoqërisë kosovare .

Struktura e punimit: Në hyrje paraqiten pikëpamje hyrëse mbi temën e studimit, duke sqaruar qëllimin dhe arsyet e hulumtimit, do të thotë ofrohet përgjigjia në pyetjen: Pse është e nevojshme të studiohet fenomeni i familjes kosovare në kontekstin e tranzicionit? Po ashtu, theksohet rëndësia e hulumtimit, si dhe kontribumi i tij në fushën e studimeve sociologjike dhe demografike. Në fund, paraqitet struktura e punimit, duke ofruar një përmbledhje të shkurtër të kapitujve dhe përmbajtjes së tyre. Në kapitullin e parë shqyrtohet kuptimi i emigracionit, teoritë sociologjike mbi migrimin. Kapitulli i dytë i shpjegon metodat e kërkimit, instrumentet tjera matëse, mostrën dhe hipotezat e kërkimit. Në kapitullin i tretë trajtohen karakteristikat e sotme gjeografike dhe demografike të Kosovës, popullsia e Kosovës përgjatë dekadave dhe historia e ndryshimeve demografike në Kosovë përgjatë dekadave në kontekst të emigrimit dhe imigrimit. Ndërkaq kapitulli i katërtë i trajton teoritë sociologjike mbi natalitetin, sidomos teoria ekonomike teoria e tranzicionit demografik, teoria e funksionalizmit strukturor, teoria e konfliktit, teoria e ndërveprimit simbolik dhe teoria kulturore. Në kapitullin e pestë nxirren përfundimet dhe sugjerimet të cilat mbështeten nga të dhënat empirike në terren dhe të dhënat tjera si burime teorike ashtu edhe dokumente të shkruara zyrtare. Në këtë pjesë paraqiten një përmbledhje e gjetjeve kryesore të hulumtimit, të cilat reflektojnë mbi mënyrën se si faktorët ekonomikë, politikë dhe kulturorë kanë ndikuar në emigrim dhe natalitet, si dhe pasojat që këto ndryshime kanë për familjen kosovare dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Në pjesën e gjashtë bëhet analiza e të dhënave të kërkimit, respektivisht realizohet faza e mbledhjes, përpunimit dhe krahasimit të variableve të varuara dhe atyre të pavarura, sidomos analizës sasiore dhe cilësore të dhënave të grumbulluara nga terreni. Pjesa e nxjerrjes së përfundimeve dhe sugjerimeve mbështet në fuqinë e provave empirike dhe analizës së tyre. Ky punim doktore ka arritur të konfirmoj pyetjet e parashturara dhe hipotezat e vëna sipas të cilave shkaqet themelore mbi emigracionin e lartë në Kosovë janë: papunësia, standardi i ulët, mungesa e perspektivës, dhe mungesë të kapacitetit për udhëheqje politike. Të gjitha këto rrethana janë sfida për familjen kosovare, e cila gjithnjë e më tepër po e humbë funksionin e saj social.

Pjesë e veçantë e disertacionit është edhe shtojca me pyetësorin anketues dhe pyetjet nga intervistimi, si edhe bibliografia me burimet dhe referencat e përdorura në këtë punim.

Vlerësim dhe rekomandim

Mbështetur nga vlerësimet e më sipërme Komisioni shkencor për vlerësimin e punimit të doktoraturës me titull "Sfidat e familjes kosovare në tranzicion: emigracioni dhe nataliteti", të kandidatës mr.sc. Hana Shala, ka nderin që t'i prpropzojë Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij raporti dhe krijimin e kushteve për mbrojtjen publike të kësaj teme të doktoratues.

Komisioni:

1. Prof.dr. Kushtim Ahmeti)
2. Prof.dr. Ibish Kadriu, (anëtar)
3. Prof.dr. Qani Nesimi, (anëtarë)
4. Prof.dr. Ardita Abduli -Reka (anëtarë)
5. Prof.dr. Abdynaser Sinani (mentor)

